



FTESË PËR PJESËMARRJE
NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR “WINE VISION BY OPEN BALKAN”,
BEOGRAD, SERBI 2024

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në cilësinë organizatorit për pjesëmarrje, Ju fton të bëheni pjesë e Panairit Ndërkombëtar "**Wine Vision by Open Balkan**" që zhvillohet në datat **22 - 24 nëntor 2024, në Beograd, Serbi**, i cili ka si qëllim promovimin e prodhimit të verës si dhe vendosjen e partneriteteve dhe bashkëpunimeve mes grupeve të interesit.

Në këtë panair pritet të marrin pjesë kompani nga rajoni dhe vende të tjera të botës, ku do të ketë pjesëmarrje të përfaqësuesve të industrisë HORECA, distributorëve, shitësve me pakicë, etj. Gjatë panairit do të organizohen një sërë seminaresh, konkurse për verën më të mirë, takime B2B, etj.

Grupet e synuara për të marrë pjesë në këtë panair janë kompanitë që operojnë kryesisht në sektorin e prodhimit të verës.

Ftojme të gjitha kompanitë që i përkasin kategorisë së sipërpërmendur, të cilat kanë mundësi dhe sasi eksportuese që të marrin pjesë në “Wine Vision by Open Balkan 2024” duke na dërguar me e-mail një prezantim të shkurtër të kompanisë duke përfshirë dhe kapacitetet eksportuese.

*Për të siguruar pjesëmarrjen, lutemi të konfirmoni brenda dates **18 tetor 2024** në info@bujqesia.gov.al*

Në vijim, do t’Ju informojmë mbi detaje të mëtejshme rreth pjesëmarrjes Suaj në këtë panair.